

PKR.nr.49/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA gjykata e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarëve profesionistë, Suzana Çerkini, kryetare, Afërdita Bytyqi dhe Arben Hoti, anëtarë, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.I., nga P., për shkak të veprës penale Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par. 1 të KPK, lidhur me nenin 31 të KPK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.456/2014, të datës 01.08.2014, pas shqyrtimit kryesor, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 26.10.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Besa Krajku dhe të akuzuarit K.I., të njëjtën ditë, mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K.I., i biri i R., dhe nënës V., e vajzërisë R., i lindur me *data e lindjes...*, në P., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, me datë 10.05.2014, rreth orës 15:00 në rrugën "Ahmet Krasniqi" te rrethi i Dragodanit në Prishtinë, derisa ishte me A. M., gjatë kontrollit që iu bë veturës së tyre të tipit "Polo", ngjyrë të kaltër, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, pronar i së cilës veturë ishte K.I., u janë gjetur 12 qese substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë me peshë prej 32.7 gram, ndërsa tek i akuzuari K.I. janë gjetur dhe konfiskuar 0.9 gram marihuanë si dhe një mulli për bluarjen e marihuanës,

- me këtë ka kryer veprën penale në bashkëkryerje Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,43, 62 par.2.6, 69, 73, 74,75, 76 par.1 pika 1.4 të KPRK dhe neneve 326, 357, 359, 365 dhe 366 të KPP i shqipton,

DËNIM ME BURGIM DHE ME GJOBË

Në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 10.05.2014 deri me datën 19.11.2014,

Në shumë prej **300 € (treqind) euro**, të cilën gjobë obligohet t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, si dhe,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: një qese marihuanë me peshë prej 0.9 gram, si dhe një mulli për bluarje të marihuanës, të precizuara në vërtetimin e bashkangjitur në shkresa të lëndës, mbi marrjen e përkohshme të sendeve Nr.2014-AB-1752, të datës 11.05.2014, si mjet i kryerjes së veprës penale,

I akuzuari obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej **50 euro (pesëdhjetë)** brenda afatit prej 15 ditëve, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP.I.nr.456/2014, të datës 01.08.2014, ka akuzuar A. M. dhe K.I., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të akuzuarit t'i shpall fajtor, dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, ka filluar procedurën me shqyrtim fillestar të mbajtur me datë 17.09.2014, për të vazhduar me shqyrtim gjyqësor deri në nxjerrje të vendimit gjyqësor për të akuzuarin A. M., ndërsa për të akuzuarin K.I., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 05.02.2015, ka veqar procedurën për shkak se i njëjti ka

qenë i paarritëshëm për organet e ndjekjes. Në zbatim të urëdhër arrestit të datës 10.08.2016 për të akuzuarin K.I., të lëshuar nga kjo gjykatë, është siguruar prania e të njëjtit në procedurë, ashtu që në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 26.10.2016, i akuzuari K.I. i vënë në dijeni të plotë për natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, vullnetarisht ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Prokurori i shtetit shprehu pajtimin për pranimin e fajësisë nga i akuzuari, sepse pranimi është në përputhje me dispozitat ligjore e provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet dhe, pajtimin për pranimin e fajësisë së të akuzuarit nga prokurori i shtetit, gjykata gjithashtu e aprovon fajësinë nga i akuzuari, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, dhe se ky pranim është bërë vullnetarisht dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Në vazhdim, prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare deklaroi, se nga vetë pranimi i fajësisë si dhe nga shiqimi i shkresave të lëndës, vërtetohet se i akuzuari K.I., ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, andaj i propozoi gjykatës që të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit dhe, me rastin e shqiptimit të dënimit propozoi si rrethanë lehtësuese të merret fakti se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale në fjalë.

I akuzuari K.I., në fjalën përfundimtare deklaroi se shpreh keqardhje për atë çfarë ka ndodh, duke theksuar se prej dhjetorit 2014, ka dalë jashtë Kosovës, saktësisht në Gjermani, me qëllim të kërkimit të një jete më të mirë, por para një muaji e kanë deportuar dhe se, asnjëherë tjetër nuk ka përsëritë veprën të tillë, në fund i premtoi gjykatës se edhe në të ardhmen nuk do të kryej asnjëherë veprën të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të akuzuarit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit K.I., ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale në bashkëkryerje Blerja posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK dhe, i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin e shprehur, premtimin e dhënë se nuk do të përsërisë veprën penale, paraqitjen korrekte në gjykatë, moshën e re, ndërsa ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese nuk gjeti, andaj të akuzuarit në aplikim të dispozitave përkatëse ligjore i shqiptoi dënim të zbutur, me burg dhe me gjobë të precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë së të akuzuarit, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtit, në ngritjen

e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale, dhe se me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK, në fund, me bindje se i akuzuari në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në arrest shtëpiak, gjykata e mori në bazë të nenit 83 par.1 të KPRK.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të substancës narkotike, të përdorur në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 273 par.5 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.49/15, me datë 26.10.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.